

Kryetari i Bashkisë

Dionis Imeraj ka lindur më 07.12.1983 në Bulqizë, me origjinë nga fshati Zall-Kalis, Sllovë, Dibër.

Arsimimi:

- Në vitet 1998-2002 ka kryer shkollën e mesme “Eqerem Çabej” në Tiranë.
- Në vitin 2002-2006 ka kryer studimet e larta “Administrim Biznes” tek Fakulteti i Ekonomisë, pranë Universitetit të Tiranës.
- Në vitet 2012- 2013 ka kryer studimet master në “Financë dhe Menaxhim Risku” pranë Universitetit “Luarasi”.
- Që nga viti 2006 e në vazhdimësi deri në ditët e sotme ka ndjekur një sërë trajnimesh e kualifikimesh në financë dhe menaxhimin e sektorit bankar, gjë që e dëshmojnë edhe certifikatat e shumta që disponon. Këto trajnime i kanë zgjeruar dhe afirmuar më tej aftësitë profesionale.

Përvoja e punës

- Në vitin 2007-2008, punoi si Specialist i shërbimeve financiare në agjensinë e ndërmjetësimit “Progres 3”Ltd.
- Në vitin 2009- 2014 , punoi në sektorin bankar, konkretisht pranë NBG Bank.
- Në vitin 2014-2017, punoi si Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Dibër.
- Në vitin 2017-2019, punoi si Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

Zotëron

- Njohës në nivel shumë të mirë 3 gjuhë të huaja, Anglisht, Frengjisht, Italisht.
- Njohës në nivel shumë të mirë i programeve të ndryshme kompjuterike, Microsoft Office dhe programe financiare.

Fuksionet Politike

- Pjesë aktive e stukturave të partisë socialiste prej kohësh. Gjatë angazhimit të tij pranë kësaj force politike ai ka mbajur detyra të rëndësishme:
- Në zgjedhjet për kryetar të Bashkisë Dibër, 2016, Koordinator Elektoral i Qarkut Dibër.
- Në zgjedhjet qendrore 2017 Koordinator Elektoral i Qarkut Tiranë.

Pas zgjedhjeve lokale të 30 Qershorit 2019, Dionis Imeraj është Kryetar i Bashkisë Dibër.